

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ID ALBANIA" SHPK

**AKTI I THEMELIMIT
DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"ID ALBANIA" SHPK**

AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ID ALBANIA” SHPK

Sot, me date 05.01.2023, ne Tirane, personat me te dhenat si me poshte:

Matilda KURTI, e bija e Agim, e dtl 02.07.1993, lindur ne Tirane, dhe banuese ne Tirane, shtetase shqiptare, madhore, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtese e leternjoftimit me nr. Personal J35702064M, e cila perfaqeson 50 % te kuotave te shoqerise.

Olgert ALLA, i biri i Sali, i datelindjes 14.06.1981, lindur ne Librazhd, dhe banues ne Tirane, shtetesi shqiptare, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, mbajtes i leternjoftimit me nr. Personal I10614084B, i cili perfaqeson 50 % te kuotave te shoqerise.

Duke vepruar ne cilesine e Ortakeve Themelues, vendosen te themelojne Shoqerine me Pergjegjesi te Kufizuar “ID ALBANIA” SHPK dhe vendosi te aprovoje kete Akt Themelimi dhe Statutin e Shoqerise sipas termave dhe kushteve te meposhtme:

TITULLI I

EMRI I SHOQERISE - REGJIMI JURIDIK - SELIA - KOHEZGJATJA

Neni 1

Emri i Shoqerise

1.1 Ne perputhje me legjislacionin shqiptar, eshte krijuar Shoqeria “ID ALBANIA” SHPK, ne vijim referuar si “Shoqeria”.

1.2 Shoqeria ka logon dhe vulen e vet zyrtare.

1.3 Shoqeria ka adresen e-mail id.albania@yahoo.com dhe Nr.Tel +355 69 568 7080

Neni 2

Regjimi Juridik i Shoqerise


2.1 “ID ALBANIA” SHPK , eshte nje Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar.

2.2 Aktiviteti i saj eshte i organizuar sipas dispozitave te Aktit te Themelimit, Statutit dhe dispozitave ligjore ne fuqi mbi tregtine dhe legjislacionin civil ne Republiken e Shqiperise.

2.3 Me vendim te Asamblese se Pergjithshme, Shoqeria mund te ndryshoje regjimin e saj juridik, ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi dhe dispozitat e Statutit te saj.

2.4 Shoqeria fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit te saj ne Regjistrin Tregtar.

NENI 3 Selia





3.1 Shoqeria ka seline e saj ne adresen: Autostrada Tirane-Durres, km 10.

3.2 Shoqeria mund te hape ose te mbylle dege, filiale dhe / ose zyra perfaqesimi brenda Shqiperise dhe / ose jashte vendit, ose te krijoje shoqeri te tjera me Partnere apo Aksionare pjesemarres.

Neni 4 Kohezgjatja

4.1 Kohezgjatja e veprimtarise se Shoqerise eshte e pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e Shoqerise ne Regjistrin Tregtar. Ortaket e Shoqerise mund te vendosin te kufizojne kohezgjatjen e aktivitetit me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme.

TITULLI II

OBJEKTI

Neni 5 Objekti

Import-export, transport, tregtimi me shumice e pakice i mallrave dhe lendeve te para para per furrat e bukes, pasticerite, gelaterite, marketet, baret, restorantet, industrite ushqimore. Tregtia e amballazhave ushqimore. Tregtim te artikujve te ndryshem industrial e ushqimor, pijeve te ndryshme, frutave te thata, erzave.

Shoqeria mund te kryeje çdo aktivitet tjetër biznesi i cili nuk është i ndaluar nga ligji, i zbatueshem, ne Republikën e Shqiperise.

TITULLI III

KAPITALI I SHOQERISE - TRANSFERIMI I KUOTAVE- ZMADHIMI I KAPITALIT

Neni 6 Kapitali i Shoqerise


6.1 Kapitali i shoqerise eshte ne vleren 200.000 Lek (dyqind mije leke) i ndare ne 2 (dy) kuota.


Kapitali i shoqerise do te paguhet nga ortaket themelues si vijon: **Matilda KURTI, nenshkruese e 1 (nje) kuote, e barabarte me 50 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 100.000 Lek (njqind mije leke).**

Olgert ALLA, nenshkrues i 1 (nje) kuote, e barabarte me 50 % te kapitalit te shoqerise, me nje vlere prej 100.000 Lek (njqind mije leke).

6.2 Pergjegjesia e Ortakeve ndaj paleve te treta per detyrimet e marra persiper nga shoqeria eshte e kufizuar sipas pjesemarrjes se ortakut/ortakeve ne kapitalin e shoqerise.

Neni 7 Transferimi i kuotave



 3

7.1 Transferimi i kuotave te shoqerise ndaj paleve te treta i nenshtrohet se drejtes se parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te cilet mund ta ushtrojne kete te drejte sipas kushteve te percaktuara ne nenin 7.2 deri ne nenin 7.6 me poshte.

7.2 Ne rast se nje ortak "Ofruesi" kerkon te shese dhe/ose te transferoje disa ose te gjitha kuotat e tij, ortaket e mbetur ("Ortaket e mbetur") do te kene te drejten e parablerjes ne lidhje me kuoten qe ofrohen per transferim ("Kuota e ofruar"), sipas kushteve te meposhtme:

(a) Ofruesi do tu dergoje fillimit ortakëve te mbetur nje njoftim me shkrim i cili percakton perqindjen e kuotes se ofruar, cmimin dhe kushtet e tjera te transferimit te cilat duhet te pershijne Identitetin e Bleresit ("OFERTA"), duke ftuar se pari Ortaket e mbetur te blejne aksionet e ofruara;

(b) Ortaket e mbetur do te kene te drejten te blejne kuotat e ofruara perpjestimisht dhe sipas kushteve te ofertes, duke i derguar nje njoftim me shkrim ofruesit brenda nje afati prej tridhjetete (30) ditesh pas marrjes se njoftimit te Ofruesit.

7.3 Nese Ortaku me te drejte parablerjeje do te kete bere nje oferte dhe kjo oferte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere Ortaku tjetër do te rishikojë oferten e bere dhe do t'i beje Ortakut qe shet nje oferte te dyte. Nese edhe kjo oferte e dyte eshte refuzuar nga Ortaku qe shet, atehere ky i fundit (Ortaku qe shet) nuk do te kete te drejte te shesi kuoten tek nje bleres tjetër me cmim me te ulet se cmimi i ofruar nga Ortaku i preferuar ne oferten e dyte.


7.4 Ne rast se asnje nga ortakët e mbetur nuk deshiron te bleje kuoten e ofruar dhe/ose kane refuzuar te blejne kuoten e ofruar, sipas kushteve te percaktuara ketu, brenda tridhjetete diteve nga marrja e ketij njoftimi, Ofruesi do te kete te drejten ti transferoje Kuotat e ofruara nje pale te trete sipas parashikimeve te pikes 7.3 Nese ky kusht nuk eshte permblushur, Marreveshja per Shitjen e Kuotave me palet e treta do te jete e pavlefshme.

7.5 Ne rast se ndonje ose te gjithë ortakët e shoqerise blen/blejne kuotat e ofruara sipas kushteve te ofertes, sic percaktohet me siper, ky transferim do te kryhet sipas kushteve te ofertes.

7.6 Kushtet e parashikuara me siper nuk do te zbatohen ne rast transferimi te kuotave nga nje ortak tek nje shoqeri e cila ndodhet nen kontrollin e ketij ortaku ose ne rast transferimi nga nje ortak tek nje pasardhes ose pasardhes i drejperdrejte i tij ose tek bashkeshorti.

7.7 Dispozitat e neneve 7.1 - 7.6, nuk do te zbatohen ne rast transferimi te bere ne favor te ortakeve te tjere. Megjithate, ne kete rast transferimi duhet ti komunikohet fillimisht me shkrim ortakëve te tjere. Te gjitha njoftimet sipas ketij neni duhet ti dergohen edhe Shoqerise.

Neni 8 Rritja e Kapitalit



8.1 Asambleja e Pergjithshme mund te rrise kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 11 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti.

8.2 Ne rast te nje rritje te kapitalit, ortakët kane te drejte te nenshkrimt te kuotave nepermjet kontributit ne natyre ose ne te holla, ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitali e shoqerise.

8.3 Nese ndonje nga ortakët refuzoje te drejten nenshkrimt, kapitali mund te nenshkruhet nga ortakët e tjere. Ne kete rast, ortakët e tjere mund te ushtroje te drejten e tyre per nenshkrimin e kapitalit ne proporcion me perqindjen qe gezojne ne kapitalin e shoqerise.

8.4 Zmadhimi i kapitalit mund te vendoset kur e kerkone interesat e Shoqërise duke vendosur kuotat suplementare te Ortakëve. Do t'u ofrohen për nenshkrim kuota te reja vetem ortakeve ekzistues te Shoqërise.

8.5 Ortaket mund te financojne shoqerine nëpermjet financimeve me pagesa, me interes ose pa interes, qofte si kontribute ne kapital ose jo, edhe objekt rimbursimi, ne perputhje me ligjet dhe rregulloret ne fuqi.

8.6 Ne rastet kur shoqeria do te gjendet perballe rasteve te nevojshme per zmadhimin e kapitalit nepermjet financimit te ortakeve te shoqerise, atehere ortakët angazhohen te kryejne financimet perkatese.

8.7 Ne rastin kur nje ortak kundershon parashikimin e mesiperm, atehere asambleja e ortakeve do te procedoje me zmadhimin e kapitalit sipas parashikimeve te Ligjit, nderkohe qe ortakut qe nuk mer pjese ne financim i zbritet perqindja qe ai zoteron ne kapitalin e shoqerise.

8.8 Menyra e rritjes se kapitalit ne lidhje me metodar dhe afatet e pagimit te kontributeve nga ortakët do te vendoset rast pas rasti mne vendim te Asamblese se Ortakeve. Vendimet e Asamblese se Ortakeve mund te perfshine nder te tjera denimet dhe pasojat per nje ortak ne rast te mos-pageses se kontributit te rene dakord ne afatin dhe shumen e caktuar duke pershire, po pa u kufizuar, (i) zvogelimin proporcional te pjeses te ortakut ne Shoqerise, (ii) shitjen e detyruar te pjeses se ortakut ne Shoqeri, (iii) percaktimit, ne baze te nje vleresimi profesional ose formule, te vleres se cilesdo pjese te ortakut qe eshte paguar, dhe shitjen detyruar te asaj pjese ne vleren e percaktuar.



Neni 9 Zvogelimi i Kapitalit

9.1 Asambleja e pergjithshme mund te zvogeloje kapitalin e shoqerise, ne perputhje me kuorumin e percaktuar ne nenin 11 te ketij Akt Themelimi dhe Statuti. Ne çdo rast, kapitali nuk mund te reduktohet nen vleren minimale te percaktuar me ligj.

9.2 Ortaket perballen me uljen e kapitalit te shoqerise ne proporcion me kuotat e zoteruara nga secili prej tyre ne kompani.

Neni 10

Certifikata e pjesemarrjes



10.1 Secili nga ortaket gezon te drejten nje certifikate ne lidhje me perqindjen ne pjesen qe gezon ne kapitalin e shoqerise. Shoqeria nuk eshte e detyruar te leshoje me shume se nje certifikate per kuotate mbajtura se bashku nga disa Ortake dhe shperndarja e certifikates per perfaqesuesit e perbashket e anetareve do te konsiderohet e dhene ne interes te te gjitha ortakeve, ne perputhje me dispozitat e ligjit.

TITULLI IV ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 11

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise. Vendimet e Shoqerise merren ne perputhje me ligjin per shoqerite tregtare.

Asambleja e Ortakeve eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e ortakeve, vendos per çështje si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve si dhe përcaktimin e pages se administratorit
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga asambleja e ortakeve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- c) investime;
- ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.



Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 12

Administrimi

Shoqeria do te administrohet nga dy administrator te emeruar ne perputhje me kete statut.

Administratori/et e shoqerise mund te shkarkohen nga pozicioni qe ka/ne ne shoqeri ne cdo kohe nga Asambleja e ortakeve. Ne asnje rast ortakeve nuk i duhet te justifikojne apo provojne se cilat jane shkaqet per te cilat ata shkarkojne administratorin/et.



Personat e mëposhtem do të caktohen administratorët e shoqërisë.

- a) Matilda KURTI, lindur me 02.07.1993 në Tiranë dhe banuese në Tiranë, identifikuar me ID Nr. Personal J35702064M.
Administratorja do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje duke filluar nga data 05.01.2023 deri me 04.01.2028.

Speciment nënshkrimi Matilda Kurti

- b) Ogert ALLA, lindur me 14.06.1981 në Librazhd dhe banuese në Tiranë, identifikuar me ID Nr. Personal I10614084B.
Administratori do të ushtrojë kompetencat e administrimit për një afat 5 vjeçar me të drejtë ripërteritje duke filluar nga data 05.01.2023 deri me 04.01.2028.

Speciment nënshkrimi Ogert Alla

Neni 13

Kompetencat

Administratori/et kanë të drejtë dhe detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm dhe të jashtëzakonshëm të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare.
b) hapjen e llogarive bankare të shoqërisë me bankat.
c) përfundimin e marrveshjeve me palet e treta, leshimin dhe marrjen e urdher pagesave, pas miratimit me shkrim nga ortakët.
ç) nënshkrimin e të gjithë dokumentave, leshimin e faturave, transferimet në monedhe të huaj dhe vendase, flete ngarkesat etj, pagimin e detyrimeve të Shoqërisë dhe pranimin e pagesa nga palet e treta.
d) vlera e transaksioneve bankare që lejohet të kryhet nga administratori/et nuk duhet të kalojnë shumën e 20.000 Euro (nëzet mijë Euro), për levizjet e shumave me të mëdha se 20.000 Euro (nëzet mijë Euro) kërkohej miratimi i ortakëve të Shoqërisë.
dh) përfaqësojë shoqërinë tregtare.
e) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
f) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakëve të vetëm për miratim;
g) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
gj) kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
h) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Kurti

Alla

Administratori/er janë të detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve në rastet kur :

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivitetet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe
- kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

Administratori/et kanë të drejtë të kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori/et përfaqësojnë Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave të të gjitha niveleve, zyrave të tatimit taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallëve. Administratori/et angazhojnë shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Administratori/et lejohen të delegojnë kompetencat tek një person i tretë nëpërmjet një Prokure Noteriale, në rastin kur ai e gjykon si të nevojshëm për aktivitetin e Shoqërisë dicka të tilla.

Neni 14

Përgjegjësia


Administratori/et janë përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për fajet kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakeve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejnë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori/et, gjatë kryerjes së detyrave të tij/tyre, përgjigjen ndaj shoqërisë për



çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori/et veprojnë në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori/et kanë barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidarë.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori/et janë të detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit ,, Per Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

TITULLI V VITI FINANCIAR, DIVIDENTI

Neni 15

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 16

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet



Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakëve, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori/et.

Mbledhja e Ortakëve vendos rreth shpërndarjes se dividendit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 17

Ekspertet

Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer nje gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakëve te shoqërisë.



Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

Neni 18

Të ardhurat neto (Dividenti) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakeve të shoqerise.

TITULLI VI SHPERBERJA-NDARJA-BASHKIMI- LIKUIDIMI

Neni 19

Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e tij;
- b) me vendim të ortakeve te shoqerise;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit”;
- d) me vendim të gjykatës;
- e) kur shoqeria per dy vite rrjesht ka dale me humbje

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese “ Shoqeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket e Shoqerise.

Nëse Asambleja e Ortakeve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 20

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij.

Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet

e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqyrjes së ortakeve dhe administratorit.

Neni 21

Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të parkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shitja e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.
2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.
3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit " Per Tregtaret dhe Shoqërite Tregtare ", likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve, likuiduesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.
Likuiduesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuiduesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqërinë kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

Neni 22

Përfundimi i likuidimit

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuiduesi e njofton Qendrën Kombëtare të Biznesit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit".

Neni 23

Bashkimi



Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëres ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përthithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përthithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të këtij shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përthithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

Neni 24

Ndarja

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Ortakeve të Shoqërisë, duke transferuar të



gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishtazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.

2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008.

3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e këtij të fundit.

4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit ka si pasojë:

a) kalimin të shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta;

b) bërjen e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;

c) vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e tij nga Qendra Kombëtare e Biznesit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit" pa kryerjen e likuidimit.

Neni 25

Shndërrimi

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të tij në shoqëri aksionare

Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimet, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

TITULLI VII

NDRYSHME

Neni 26

Baza Ligjore


Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me kete statut dhe dispozitat e legjislatcionit shqiptarë.

Per sa nuk parashikohet në kete statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 27

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jete kompetente Gjykata Shqiptare.



TITULLI VIII

AUTORIZIME

Ortakët:

MATILDA KURTI lindur me 02/07/1993 shtetase Shqiptare, identifikuar me leternjoftimin kartë identiteti me numër personal J35702064M.

dhe

OLGERT ALLA lindur me 14/06/1981 shtetas Shqiptar, identifikuar me leternjoftimin kartë identiteti me numër personal I10614084B

Autorizojnë:

Z. OLGERT ALLA lindur me 14/06/1981, identifikuar me leternjoftimin me numër personal I10614084B, të kryejë procedurat për regjistrimin fillestar të shoqërisë pranë QKB-se.

Nenshkruhet sot me datë 05.01.2023.

**ORTAKËT E SHOQËRISE
"ID ALBANIA" SHPK**

Matilda KURTI
50% të Kuotave

Matilda Kurti
AK

Olgert ALLA
50% të Kuotave

Olgert Alla
OA